



VENDIM

Nr. 126, Datë 28.10.2013

MBI

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRIVE HEC ULËZ – SHKOPET SH.A DHE HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2 SH.A, PËR TRANSFERIMIN E LIÇENSAVE TË PRODHIMIT, TREGTIMIT DHE FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KËTO SHOQËRI TEK SHOQËRIA “KURUM INTERNATIONAL”SH.A

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20, pika 1 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 17 pikat 1, 4 gërmat “a”, “b”, “c”, 5 dhe 7 të Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të Liçensave, pikës 1.3 të Liçensës së aktivitetit të tregtimit dhe të furnizuesit të kualifikuar, Bordi i Komisionerëve të ERE në mbledhjen e datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

1. ERE në bazë të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Transferimit të Aseteve, në të cilin citohet se :*“Për transferimin e asetëve që realizohet në kuadër të procesit të privatizimeve në sektorin publik nuk do të aplikohet kjo rregullore”*, në kompetencë të saj ka vetëm trajtimin e transferimit të liçensave të subjekteve HEC ULËZ – SHKOPET Sh.a dhe HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2 Sh.a.
2. Dokumentacioni i paraqitur nga subjektet HEC ULËZ – SHKOPET Sh.a dhe HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2 Sh.a, në lidhje me transferimin e liçensave, është konform kërkesave të *“Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”* si më poshtë:

Neni 17, pika 1; pika 4, gërmat “a”, “b”, “c”

Eshte plotesuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa me sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë transferimin e licensave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga shoqëritë HEC ULËZ – SHKOPET Sh.a dhe HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2 Sh.a, tek shoqëria “KURUM INTERNATIONAL”sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë Kurum International Sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI